



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Dobësi me Nivel të Lartë në WatchGuard Firebox

Data: 04/03/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	1
Informacione Teknike	1
Rekomandime	2
Referenca	2

Përmbledhje Ekzekutive

Është identifikuar një dobësi **Out-of-Bounds Write** me nivel të lartë në **Fireware OS** që prek pajisjet **WatchGuard Firebox**. Kjo dobësi mund të lejojë një administrator të privilegjuar dhe të autentikuar të ekzekutojë kod arbitrar me privilegje **root** përmes një ndërfaqeje të ekspozuar menaxhimi, duke rezultuar potencialisht në komprometimin e plotë të sistemit.

Informacione Teknike

Detaje të Dobësisë:

- **CVE ID:** CVE-2026-3342
- **CVSS Score:** 8.6 High

Një dobësi **Out-of-Bounds Write** në Fireware OS mund të lejojë një administrator të privilegjuar të ekzekutojë kod arbitrar me privilegje të nivelit **root** përmes ndërfaqes së menaxhimit të pajisjes. Shfrytëzimi i suksesshëm mund të komprometojë **konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë** e sistemit të prekur.

Produktet e prekura:

Kjo dobësi prek versionet e mëposhtme të **Fireware OS**:

- Fireware OS 11.9 deri dhe duke përfshirë 11.12.4_Update1
- Fireware OS 12.0 deri dhe duke përfshirë 12.11.7
- Fireware OS 2025.1 deri dhe duke përfshirë 2026.1.1

Modelet e prekura përfshijnë:

- T15 dhe T35 (degë 12.5.x)
- T20, T25, T40, T45, T55, T70, T80, T85
- T115-W, T125, T125-W, T145, T145-W, T185
- M270, M290, M295, M370, M390, M395, M470, M495, M570, M590, M595, M670, M690
- M440, M4600, M4800, M5600, M5800
- Firebox Cloud, Firebox NV5, FireboxV

Versionet e rregulluara:

- 2025.1.x është rregulluar në versionin **2026.1.2**
- 12.x është rregulluar në versionin **12.11.8**
- 12.5.x (modelet T15 & T35) është rregulluar në versionin **12.5.17**
- 11.x ka arritur **End of Life** dhe kërkon përditësim në një version të mbështetur

Rekomandime

AKSK rekomandon përditësimin e versioneve të prekura në versionet e rregulluara ose në versionet më të fundit të publikuara nga WatchGuard.

Referenca

<https://www.watchguard.com/wgrd-psirt/advisory/wgsa-2026-00003>